

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot me daten 29/12/2023, bazuar ne nenin 73/1/b te Ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, si dhe nenin 705 e vijues te ligjit nr. 7850 dt.29.7. 1994 "Kod i Civil i Republikes se Shqiperise", lidhet kjo kontratë për shitje kuotash, ndermjet paleve te meposhtme:

1- **Z. Fatos Deliu**, shtetas shqiptar, i identifikuar me nr.personal H20304090J, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, në vijim i referuar si "**Shitësi**"

### Dhe

2- **Shoqëria AMPHORA HOLDING shpk**, shoqëri e të drejtës shqiptare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB) me NUIS M32106058N, me seli në adresën Rr. Teodor Keko, Unaze e Re, Tirane përfaqësuar znj. Adriana Jata me cilesine e administratorit dhe te ortakut te vetem te shoqerise, shtetase shqiptare, e identifikuar me letërnjoftim me numër personal I25212067A, madhore dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, në vijim referuar si "**Blerësi**"

### DEKLARIME PARAPRAKE:

I. Shitësi është ortak zotërues i nje kuote me vlere nominale totale prej 4,000 Euro(katër mijë) e cila perfaqeson 20% të kapitalit të shoqërisë "Sanitary Cleaning" shpk, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me NUIS L42429004B dhe seli në adresen: Rruga Teodor Keko, Nr.160, Tirane

II. Palët kanë rene dakort te transferojnë nepermjet shitjes nga Shitësi tek Blerësi kuotën e zotëruar nga Shitësi në shoqërinë Sanitary Cleaning, që përbën 20 (njëzet) % te kapitalit të kësaj shoqërie.

III. Palet lidhin dhe nënshkruajnë kete Kontrate Shitje Kuotash me kushtet si me poshte vijon:

### Neni 1

#### Objekti

1.1 Kjo kontratë ka për objekt transferimin nëpërmjet shitjes nga Shitësi tek Blerësi, të Kuotës me vlere nominale 4.000 Euro të zotëruar nga Shitësi në shoqërinë Sanitary Cleaning shpk, që përfaqëson 20 % të Kapitalit të kësaj shoqërie, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse, duke njohur Blerësin nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në të ardhmen si zotërues të Kuotës objekt i kësaj kontrate.

### Neni 2

#### Cmimi i Shitjes i Kuotës

2.1 Cmimi total i rënë dakort per Kuotën ne Shitje eshte 50.000 Euro(pesedhete mijë).

2.2 Palët deklarojnë se cmimi total per Kuotën ne Shitje, do të likujdohet i ndarë në këste si vijon:

Kësti 1: 5.000 Euro, paguhet nga Blerësi në llogarinë e Shitësit jo më vonë se 20 ditë nga nënshkrimi i kësaj Kontrate

Kësti 2: 5.000 Euro, paguhet nga Blerësi në llogarinë e Shitësit jo më vonë se 12 muaj nga regjistrimi i ndryshimit të pronësisë së kuotës nga Shitësi tek Blerësi, sipas kësaj kontrate në QKB.

Kësti 3: 10.0000 Euro, paguhet nga Blerësi në llogarinë e Shitësit jo më vonë se 24 muaj nga regjistrimi i ndryshimit të pronësisë së kuotës nga Shitësi tek Blerësi, sipas kësaj kontrate në QKB.

Kësti 4: 10.0000 Euro, paguhet nga Blerësi në llogarinë e Shitësit jo më vonë se 36 muaj nga regjistrimi i ndryshimit të pronësisë së kuotës nga Shitësi tek Blerësi, sipas kësaj kontrate në QKB.

Kësti 5: 10.0000 Euro, paguhet nga Blerësi në llogarinë e Shitësit jo më vonë se 48 muaj nga regjistrimi i ndryshimit të pronësisë së kuotës nga Shitësi tek Blerësi, sipas kësaj kontrate në QKB.

Kësti 6: 10.0000 Euro, paguhet nga Blerësi në llogarinë e Shitësit jo më vonë se 60 muaj nga regjistrimi i ndryshimit të pronësisë së kuotës nga Shitësi tek Blerësi, sipas kësaj kontrate në QKB .

### Neni 3

#### Kalimi i pronësisë së kuotave dhe regjistrimi i kalimit

3.1 Pronesia mbi kuotat në shitje i kalon Blerësit në përputhje me Nenin 1.1, ne daten e nënshkrimit të Kontrates.

3.2 Shitësi garanton se do të mundësojë që kjo Kontratë, do të regjistrohet pranë Qendres Kornbëtare të Biznesit brenda 20 ditësh(dhjete) pune zyrtare nga data e likujdimit prej Blerësit të Këstit 1 sipas nenit 2.2 të kësaj Kontrate. Në rast të kundërt Shitësi është përgjegjës për pasojat e mundshme ligjore.

#### Neni 4

##### Deklarimet dhe Garancite

4.1 Shitësi deklaron dhe garanton në lidhje me transaksionin që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijojnë:

4.1.1 *Autorizimi* – Të gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe/ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndermerren nga ose për llogari të Shitësit dhe që autorizojnë Shitësin të lidhin dhe të zbatojnë këtë Kontratë janë kryer rregullisht. Kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përben një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për të dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates.

4.1.2 *Nenshkrimi* – Nenshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon asnjë depozitim, miratim, autorizim paraprak të çfaredolloji nga ndonjë autoritet shtetëror ose pale e tretë.

4.1.3 *Pronesia* – Shitësi është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i Kuotës në shitje sic është treguar në pikën I të Deklarimeve Paraprake. Kuota është përcaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe është shlyer plotësisht nëpërmjet kontributit në para në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

4.1.4 *Kuota* - Kuota është e lirë dhe e çliruar nga çdo Barre e çfarëdo lloji dhe Shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për ta shitur, për ta kaluar, transferuar dhe dorëzuar në përputhje me afatet e kësaj Kontrate. Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë Barre në lidhje me Kuotën. Përveç kësaj Kontrate, nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që parashikon dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin ose dhenien e se drejtës një personi, të drejtën e parablerjes apo të kembimit, në lidhje me Kuotën objekt të kësaj kontrate. Shitësi garanton Blerësin se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barre, hipoteke apo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.1.5 Shitësi siguron që Shoqëria është ekzistuese dhe e vlefshme, e organizuar rregullisht dhe e themeluar sipas ligjeve në fuqi dhe nuk është në gjendje paaftesie paguese apo falimentimi ose subjekt i ndonjë procedure paaftesie paguese, likuidimi apo në procedura shitjeje në çfarëdo juridiksioni dhe nuk ka propozuar asnjë marrëveshje apo ujdë me çfarëdo klase kreditorësh dhe ka kompetencën dhe autoritetin e plotë për të menaxhuar aktivitetin dhe pronat e saj. Shoqëria ka depozituar rregullisht dhe në kohë bilancet dhe pasqyrat financiare të shoqërisë deri në fund të vitit 2022, në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe rregulloret në Shqipëri.

4.1.6 Shoqëria është e pajisur me të gjitha licensat, lejet, autorizimet dhe pelqimet e kërkuara për kryerjen e aktivitetit tregtar të treguar në objektin e saj.

4.1.7 Shoqëria ka bërë deklarinë në lidhje me pronarët përfitues fundor në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk është dhe nuk do të jetë subjekt penaliteti ndaj organeve shtetërore në lidhje me këtë deklarinë. Nëse ka penalitete në lidhje me moskryerjen në kohë të deklarinës të pronarëve fundor përpara Dates së Kontrates, për këtë do të përgjigjet vetëm Shitësi.

4.1.8 Shitësi deklaron se me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, heqi dorë nga të drejtat që kishte mbi kuotën (kapitalin) objekt të kësaj kontrate, kuotë (kapital), që menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, i kalon Blerësit, ashtu sikurse edhe çdo e drejtë apo përfitim tjetër i lidhur me to, përfshirë edhe të drejtën e Blerësit për të përfituar çdo dividend të maturuar, të deklaruar apo aprovuar deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

4.2 Blerësi deklaron dhe garanton në lidhje me transaksionin që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijojnë:

4.2.1 Blerësi, pas transferimit të Kuotës behet mbajtës/pronar/zotëruar i saj dhe të drejtave dhe detyrimeve të lidhura me të sipas përcaktimeve në Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe Statutin e Shoqërisë.

4.2.2 Blerësi ka detyrimin të paguajë të plotë cmimin e shitjes, sic është përcaktuar në nenin 1 dhe 2 të kësaj kontrate.

4.2.3 Blerësi pas transferimit të kuotave është mbajtës i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të lidhura me kuotat, përfshirë edhe pjesëmarrjen në fitimet dhe humbjet e shoqërisë, duke filluar nga viti ushtrimor aktual pa kufizime.

#### Neni 5

##### Shpenzimet e Kontrates së Shitjes së Kuotave

5.1 Secila Pale merr përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjrisht për shitjen e Kuotave.

5.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim qe duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit te kesaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotave, merret përsipër nga pala qe është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk percakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

#### Neni 6

#### Interpretimi I Kontrates

6.1 Kjo kontrate do te interpretohet duke konsideruar parashikimet e saj ne teresi. Ne cdo rast, ne se ndonje nen ose fjale eshte e paqarte, ajo duhet te shikohet ne teresine e Kontrates dhe ne kuadrin e qellimeve te te dyja paleve per te lidhur kete Kontrate.

#### Neni 7

#### Informacioni dhe Dokumentet

7.1 Informacioni dhe dokumentet ne kete Kontrate jane te verteta , te perditesuara dhe te plota, deri ne kete date.

#### Neni 8

#### Mosmarreveshjet

8.1 Mosmarreveshjet qe lindin nga kjo kontrate do te zgjidhen me mirekuptim nga palet, ne rast te kundert palet do ti drejtohen Gjykates Kompetente Shqiptare.

#### Neni 9

#### Te ndryshme

9.1 Kjo kontrate eshte hartuar dhe do te interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

9.2 Kjo kontratë prevalon mbi cdo marrëveshje tjetër të konkluduar dhe nënshkruar mes palëve para nënshkrimit të kësaj kontrate.

9.3 Kjo kontrate eshte hartuar ne 5 (pesë) kopje ne gjuhen shqipe, me te njejten vlere ligjore

Kontrata pasi lexohet nga palet dhe gjendet prej tyre ne perputhje te plote me vullnetin e shprehur ne te, nenshkruhet pa verejtje.

#### SHITËSI

z. Fatos Deliu

Jap pelqimin:

Bashkëshortja e Shitësit:

znj. Adriana Jata

#### BLERËSI

Per: AMPHORA HOLDING

znj. Adriana Jata



**V E N D I M**  
**I ASAMBLESE TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**“Sanitary Cleaning” sh.p.k.**

Sot ne daten 29/12/2023, per shoqerine “Sanitary Cleaning” Sh.p.k., Person Juridik i se drejtes Shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT: L42429004B, me adresen Tirane, Unaza e Re, Rr. Teodor Keko, Nr.160, Asambleja e Ortakeve te Shoqerise e perbere nga ortaket:

- 1- Ortaku **Berinv BV**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe regjistruar ne baze te legjislacionit Hollandez, me numer tergetar 71211136, zoterues i nje kuote qe perben 60% te kapitalit te shoqerise Sanitary Cleaning shpk, e perfaqesuar ne kete mbledhje nga ortaket se saj:
  - a) **Z. Fatos Deliu**, shtetas shqiptar, i indetifikuar me nr. personal: H20304090J, madhor dhe me zotesi te plote ligjore per te vepruar, zoterues i 50% te kapitalit te shoqerise Berinv BV.
  - b) **Z. Bekim Jata**, shtetas shqiptar, i indetifikuar me nr. personal: H60624134G, madhor dhe me zotesi te plote ligjore per te vepruar, zoterues i 50% te kapitalit te shoqerise Berinv BV.
- 2- Ortaku **Z. Fatos Deliu**, shtetas shqiptar, i indetifikuar me nr. personal: H20304090J, madhor dhe me zotesi te plote ligjore per te vepruar, zoterues i nje kuote qe perben 20% te kapitalit te shoqerise Sanitary Cleaning shpk.
- 3- Ortaku **Z. Bekim Jata**, shtetas shqiptar, i indetifikuar me nr. personal: H60624134G, madhor dhe me zotesi te plote ligjore per te vepruar, zoterues i nje kuote qe perben 20% te kapitalit te shoqerise Sanitary Cleaning shpk.

**K O N S T A T O I S E :**

Bazuar ne Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligjit Nr: 9901 date 14/04/2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare” si dhe ne funksion te plote te Statutit te shoqerise “Sanitary Cleaning” sh.p.k., Asambleja e Ortakeve te shoqerise morri ne shqyrtim pikat e rendit te dites si me poshte vijon:

Diskutimi i propozimit te Ortakut z. Fatos Deliu, i cili kerkon te shese kuoten e vet e cila ka vlere nominale 4.000 Euro dhe perfaqeson 20% te kapitalit te shoqerise “Sanitary Cleaning” sh.p.k.. Cmimi i propozuar nga shitesi eshte ne vleren 50.000 Euro.

Diskutimi i propozimit te Ortakut z. Fatos Deliu, ne zbatim te Ligjit Nr: 9901 date 14/04/2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare” si dhe ne funksion te plote te Statutit te shoqerise “Sanitary Cleaning” sh.p.k., nese ndonjeri nga ortaket te tjere te shoqerise shpreh interes per te blere kuoten qe ky i fundit ka nxjerre ne shitje.


Nese ortaket e tjere nuk shprehin ineteresin per blerjen e kutes se ortakut Fatos Deliu, atehere ti jepet e drejta atij ta shesi kuoten tek persona te trete te cilet nuk jane ortake te shoqerise, me te njejtin çmim qe u eshte ofruar edhe ortakeve ekzistues te shoqerise.

Ne kushte kur ortaket i japin te drejten atij ta shesi kuoten tek persona te trete te cilet nuk jane ortake te shoqerise me te njejtin çmim qe u eshte ofruar edhe ortakeve ekzistues te shoqerise, Ortaku z. Fatos Deliu kerkoj ne Asamble qe kuoten e vete tj shese shoqerise Amphora Holding shpk me Nipt: M32106058N per cmimin 50.000 Euro.

Pas diskutimit ne lidhje me ceshtjet e rendit te dites, ne mbeshtetje te Statutit te shoqerise, Ligjit Nr,9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, Kodit Civil ne RSH, te Ligjit nr. Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” i ndryshuar”, Asambleja e Ortakeve te shoqerise “Sanitary Cleaning” sh.p.k.,

**V E N D O S I :**

- 1- Miratimi i kerkeses se Ortakut Fatos Deliu per shitjen e kuotes se vet e cila ka vlere nominale 4.000 Euro dhe perfaqeson 20% te kapitalit themeltar te shoqerise “Sanitary Cleaning” sh.p.k.. Shitja do te behet me cmimin 50.000 Euro (pesedhjetë mije).
- 2- Ne zbatim te Ligjit Nr: 9901 date 14/04/2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare” si dhe ne funksion te plote te Statutit te shoqerise “Sanitary Cleaning” sh.p.k., duke qene se ortaket e tjere nuk shprehin interes per blerjen e kuotes se nxjerre ne shitje nga ortaku Fatos Deliu, miratojne shitjen e kuotes nga Fatos Deliu tek Shoqeria Amphora Holdind shpk me Nipt: M32106058N, me cmimin 50.000 Euro(pesedhjetë mije).



# Shoqeria: Sanitary Cleaning sh.p.k.

Nipt: L42429004B

- 3- Pas realizimit dhe regjistrimit te kontrates se shi-blerjes se kuotes, raporti i pronesisë ne kapitalin themeltar te shoqerise "Sanitary Cleaning" sh.p.k. ndryshon dhe behet si me poshte vijon:

## **Ndryshimet:**

- Largohet nga shoqeria Ortaku z. Fatos Deliu.
- Shtohet Orakaku Shoqeria Amphora Holdind shpk me Nipt: M32106058N duke u bere zoteruese e nje kuote me vlere nominale 4.000 Euro e cila perfaqeson 20% te kapitalit te Shoqerise "Sanitary Cleaning" Sh.p.k..

## **Zoterimi i kapitalit pas ndryshimeve:**

- Ortaku Berinv BV, zoteron nje kuote me vlere nominale 12.000 Euro, e cila perfaqeson 60% te kapitalit te shoqerise Sanitary Cleaning shpk.
- Ortaku z. Bekim Jata, zoteron nje kuote me vlere nominale 4.000 Euro, e cila perfaqeson 20% te kapitalit te shoqerise Sanitary Cleaning shpk.
- Orakaku Shoqeria Amphora Holding shpk me Nipt: M32106058N, zoteron nje kuote me vlere nominale 4.000 Euro, e cila perfaqeson 20% te kapitalit te shoqerise Sanitary Cleaning shpk.

Duke qene se nuk kishte me çeshtje per te diskutuar dhe ortaket e shoqerise konstatojne qe vendimet e marra jane ne perputhje te plote me Ligjin dhe me Satatutin e shoqerise, mbledhja u mbyllet dhe ortaket nenshkruan vendimet e mesiperme me vullnetin e tyre te lire.

**Vendimi u morr ne menyre unanime nga te gjithe ortaket e shoqerise**


**Per shoqerine Sanitary Cleaning sh.p.k.**

Per Ortakun: **Berinv BV**

Fatos Deliu



Bekim Jata



Ortaku

Fatos Deliu



Ortaku

Bekim Jata



Shoqeria: "Amphora Holding" sh.p.k.

Nipt: M32106058N

**V E N D I M**  
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE**  
**"Amphora Holding" sh.p.k.**

Sot ne daten 29/12/2023, znj. Adriana Jata, Ortak i Vetem i shoqerise "Amphora Holding" Sh.p.k., Person Juridik i se drejtes Shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT: M32106058N, me adresen Tiranë, Unaza e Re, Rruga Teodor Keko, pallati Pelikan, hyrja 1, kati 9, apartamenti 31:

**K O N S T A T O I S E :**

Bazuar ne, Ligjit Nr: 9901 date 14/04/2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" si dhe ne funksion te plote te Statutit te shoqerise "Amphora Holding" sh.p.k., Ortaku i vetem i shoqerise mori ne shqyrtim pikat e rendit te dites si me poshte vijon:

Diskutimi per blerjen e nje kuote qe zoteron z. Fatos Deliu ne shoqerine "Sanitary Cleaning" shpk me Nipt: L42429004B, i cili kerkon te shese kuoten e cila ka vlere nominale 4.000 Euro dhe perfaqeson 20% te kapitalit te shoqerise "Sanitary Cleaning" shpk, me cmimi ne vleren 50.000 Euro.

Ne Asamblene e Ortakeve te Shoqerise "Sanitary Cleaning" shpk te dates 16/10/2023, ortaket e tjere te saj nuk kane shprehur interes per te blere kete kuote dhe kane vendosur ti japin te drejte ortakut Fatos Deliu qe tja shese kuoten e tij shoqerise Amphora Holding shpk me Nipt: M32106058N per te njejtin cmimin qe iu eshte ofruar ortakeve te tjere, ne shumen prej 50.000 Euro.

Ortaku i vetem i shoqerise Amphora Holding diskutoi per blerjen e kuotes qe shet z. Fatos Deliu dhe autorizimin e administartorit per te perfaqesuar shoqerine Amphora Holding ne negociimin e kushteve te pergjithshme dhe te pageses dhe per nenshkrimin e kontrates se transferimit te kuotes.

Pas diskutimit ne lidhje me ceshtjet e rendit te dites, ne mbeshtetje te Statutit te shoqerise, Ligjit Nr,9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil ne RSH, te Ligjit nr. Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar", Ortaku i Vetem i shoqerise "Amphora Holding" sh.p.k.,

**V E N D O S I :**

- 1- Miratimin e blerjes se kuotes qe zoteron z. Fatos Deliu ne shoqerine "Sanitary Cleaning" shpk me Nipt: L42429004B, me cmim 50.000 Euro, e cila ka vlere nominale 4.000 Euro dhe perfaqeson 20% te kapitalit te shoqerise "Sanitary Cleaning" shpk.
- 2- Autorizimin e administartores znj. Adriana Jata per te perfaqesuar shoqerine gjate negociimeve te kushteve pergjithshme dhe pageses dhe per te nenshkrua kontraten e transferimit te kuotes ndremjet shitesit z. Fatos Deliu dhe bleresit shoqerise Amphora Holding shpk. .

Duke qene se nuk kishte me ceshtje per te diskutuar dhe ortakut i vetem i shoqerise konstaton qe vendimet e marra jane ne perputhje te plote me Ligjin dhe me Statutin e shoqerise, mbledhja u mbyllet dhe ortakut nenshkroi vendimet e mesiperme me vullnetin e tij te lire.

**Vendimi u mor nga Ortaku i Vetem**

**Adriana Jata**

*Adriana Jata*  
  


# Njoftim Debitimi / Debit Advice



**Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX**

Dega / Branch 900

Data / Date 09/01/2024

## Payment Reference

Klienti Urdherues / Ordering Customer	AMPHORA HOLDING SHPK M32106058N
Numri i llogarise / Account Number	0011944694
IBAN	AL8120211226000000011944694
Shuma e urdheruar	5,000.00
Monedha	EUR
Kursi i kembimit	1.00000000
Detajet e pageses / Details of Payment	Lik pjesor fature nr 1/2024 dt 03. 01.2023, blerje kuotash . 6 608c764-8620-440b-bde5-a62eadf6102c
Komisione / Commissions	
Klienti Perfitues / Beneficiary Customer	FATOS SELIM DELIU (Mar 4 1972 )
Numri i llogarise	0021334607
IBAN	AL6920211226000000021334607
Date Valuta / Value Date	10/01/2024

### **Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!**

*Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.*

**Amphora Holding**

NIPT: M32106058N

Adresa: Tiranë, Unaza e Re, Rruga Teodor Keko, pallati Pelikan,  
hyrja 1, kati 9, apartamenti 31, Tirane**FATURË - TH**  
VETËFATURIM**SHITËSI:**

Fatos Deliu

Adresa: Rr. Abdÿrraman Sedja, Nd.49, H.1

Qyteti: Kavaje

Shteti: ALB

Kartë identiteti: H20304090J

Data: 03-01-2024 22:11:05

Numri: 1/2024

Operatori: nx207cl312

Vendi i ushtrimit të veprimtarisë:  
it502cn441

Afati i pagesës: 31-12-2028

Mënyra e pagesës: Transaksion nga llogaria  
Raiffeisen Bank sh.a-EUR-  
AL8120211226000000011944694;

Kursi i këmbimit: EUR 1x103.88

Data e furnizimit : 31-12-2023

Shënime: Shitje Kuota Kapitali te shoqerise  
Sanitary Cleaning Shpk, 1 kuote(20% e kap.  
total) nga Fatos Deliu tek Amphora Holding  
sipas Kontrates se Shitje Kuotash

Artikulli/ Shërbimi	Kodi	Njësia	Sasia	Çmimi pa TVSH	Vlefte pa TVSH	TVSH	Vlefte me TVSH
Shitje Kuota Kapitali te shoqerise Sanitary Cleaning Shpk, 1 kuote(20% e kap. total) nga Fatos Deliu tek Amphora Holding sipas Kontrates se Shitje Kuotash	Kuote	Vlere monetare	1.00	50,000.00	50,000.00	Pa TVSH	50,000.00

**Nivelet e TVSH**

TVSH	Vlera pa TVSH	Vlera e TVSH	Total pa TVSH	50,000.00 EUR
Pa TVSH	50000	0	TVSH	0.00 EUR
			Total me TVSH	50,000.00 EUR
			Total pa TVSH	5,194,000.00 LEK
			TVSH	0.00 LEK
			Total me TVSH	5,194,000.00 LEK

NSLF: EE38805E3470EF4C88F74A12FD32A8FC

NIVF: 6608c764-8620-440b-bde5-a62eadf6102c



Të gjitha informacionet në lidhje me këtë faturë mund të shihen në këtë kod QR

Blerës  
(Emër, Mbiemër, Firmë)Transportues  
(Emër, Mbiemër, Firmë)Shitës  
(Emër, Mbiemër, Firmë)



---

Te gjitha komisionet bankare paguhen nga bleresi. All bank commissions will be paid full by the buyer.

Tatimpaguesi nuk ka detyrimin për të llogaritur TVSH-në në shitje për furnizimet e mallrave ose sherbimeve të kryera prej tij

